




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS PËR VITIN 2022

Prishtinë, maj 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës (KMAL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Malishevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Malishevës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në dosjen e tenderit, në katër (4) raste, nuk ishte bashkangjitur Projekti Ekzekutiv si pjesë e specifikave teknike.
- B1 Vonesat në pagesa, pesë (5) fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat për këto raste ishin nga 171 ditë deri në 327 ditë.
- B2 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale të prezantuara në PFV, ishin të mbivlerësuara si pasojë e mos zhvlerësimit në disa raste.
- B3 Komuna ka përdorë fondet e projekteve për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Malishevës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Malishevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Malishevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Malishevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Malishevës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat për përmirësim janë si: planifikimet dhe realizimi buxhetor për investimet kapitale, klasifikimi jo i duhur i shpenzimeve, procedurat e prokurimit publik, menaxhimin e pasurisë, llogarive të arkëtueshme dhe vonesave për pagesën e faturave të pranuar. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja dhe pesë (5) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mungesë e projektit ekzekutiv si pjesë e specifikave teknike

Gjetja

Neni 28.10 i LPP kërkon që: Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në dosjen e tenderit nuk ishte bashkëngjitur Projekti Ekzekutiv si pjesë e specifikave teknike, për këto procedura tenderuese:

- "Ndërtimi i sheshit dhe rrugës Ibrahim Mazreku në qytetin e Malishevës";
- "Ndërtimi i urës afër shkollës fillore Imer Krasniqi në fshatin Carrallukë";
- "Ndërtimi i rrugës Gurbardh - Turjakë komuna Malishevë"; dhe
- "Ndërtimi i fushave të futbollit të vogël në fshatin Kijevë-lagjja Stapanicë".

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në planifikimin dhe iniciimin për projektet investuese.

Ndikimi

Kjo mund të ndikoj në nevojën për ndryshime, korrigjime dhe punë shtesë (aneks kontrata) gjatë realizimit të punëve për këto projekte.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të rishikoj kontrollet e vendosura në procesin e planifikimit dhe iniciimit të projekteve investuese dhe të siguroj se gjatë përgatitjes së specifikave teknike për projekte investuese të kenë të përgatitur edhe projektin ekzekutiv, dhe të njëjtin t'ia bashkëngjisin dosjes së tenderit me rastin e publikimit të saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mangësi në regjistrim dhe vlerësim/zhvlerësim të pasurive jo financiare

Gjetja

Neni 1 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të Regjistrit të Pasurive jo Financiare Kapitale, si pjesë integrale e SIMFK-së, dhe Regjistrit të Pasurive jo Financiare jo Kapitale me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerës së tyre, si dhe proceset adekuate, efikase, efektive dhe transparente të tjetërsimit të pasurive jo financiare.

Me rastin e testimit të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€, kemi identifikuar dobësitë si në vijim:

- Pasuria e regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK me emërtimin “Rregullimi i asamblesë K.K. Malishevë” në vlerë 22,643€ dhe “rregullimi i zyrës së ofiqarisë” në vlerë 1,083€ janë regjistruar me statutin “Investim në vijim” që nga viti 2015. Si rezultat i këtij regjistrimi, nuk ju ishte kalkuluar zhvlerësimi për shtatë (7) vite, duke e mbivlerësuar vlerën neto të pasurisë së komunës për 5,045€.
- Pasuria e regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK me emërtimin “Ndërtesat e banimit furnizim me material ndërtimor për skamnoret” në vlerë 15,792€, dhe “Furnizim me material ndërtimi për familjet skamnore” në vlerë 10,050€, këto dy pasuri nuk i plotësonin kushtet për tu regjistruar si pasuri e komunës, meqenëse ishin ndihmë ndaj qytetarëve me kushte të vështira ekonomike. Andaj si rezultat i kësaj pasurie e komunës ishte mbivlerësuar për 25,842€.
- Pasuritë e regjistruara në regjistrin e pasurisë në SIMFK me emërtime të ndryshme “Ndërtimi i rrugëve lokale ose nëpër fshatra, i anekseve të shkollave, dhe i kanalizimeve të Malishevës” në nëntë (9) raste, ishin mbet të regjistruar me statutin “Investim në vijim”. Si rezultat i sajë, nuk ju ishin kalkuluar shpenzimet e zhvlerësimit, edhe pse këto pasuri ishin në përdorim nga vitet 2015 deri në 2018. Kjo kishte ndikuar në mbivlerësimin e këtyre pasurive për 48,708€.

Për më tepër, regjistrimi i pasurisë jo kapitale (me vlerë nën 1,000€) në sistemin “e-pasuria” kishte probleme, dhe mungesë të regjistrimit të këtyre pasurive për vitin 2021. Vlera e pasurive nën 1,000€ në PFV ishte prezantuar në shumë 208,783€, por në listën e këtyre pasurive vërehet se disa pasuri nuk kanë të regjistruar “Zhvlerësimin e tanishëm” dhe “Zhvlerësimin e akumuluar” respektivisht e kanë vlerën me zero. Kjo si pasojë e mos funksionimit të sistemit e-pasuria, i cili gjatë vitit 2020 dhe 2021 nuk kishte aplikuar zhvlerësimin e tyre dhe kjo kishte ndikuar në shumën e zhvlerësimit të pasurisë në fund të vitit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të kontrolleve të brendshme ndaj menaxhimit të pasurive jo financiare në vitet e kaluara dhe të mungesës së zyrtarit për menaxhimin e pasurive në dy vitet e kaluara.

Ndikimi

Mos regjistrimi i duhur i pasurive sipas jetës së përdorimit, dhe mos korrigjimi i regjistrimit të pasurive sipas ndryshimeve të pronësisë dhe vlerës së pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrimit të pasurisë.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendshme për korrigjimin e regjistrimit të pasurive, dhe në veçanti duke i verifikuar dhe korrigjuar vlerat e pasurive me statutin “Investime në vijim” dhe nëse jetëgjatësia e përdorimit të pasurive është ajo e përcaktuara me rregullore dhe që vlera e pasurive të prezantohet e saktë. Po ashtu pasuria nën 1,000€ të regjistrohet e gjitha në sistemin “e-pasuria”.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Ekzekutimi i pagesave për projekte të caktuara nga buxheti i projekteve tjera**Gjetja**

Ligji nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022, neni 16 pika 1, tregon se, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, duhet të miratohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Ministri i financave mundet, nëse i ofrohen arsye të vlefshme nga ana e kryesuesit të organizatës buxhetore, të autorizojë lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital në tjetrin brenda nën-programit të njëjtë të asaj organizate buxhetore. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Nga testimi i pagesave të punëve të kryera të projekteve kapitale, kemi hasur në disa raste të pagesave që janë realizuar pa u zbatuar procedurat e duhura. Rastet kishin të bënin për:

- “Renovimi i objekteve të institucioneve arsimore në komunën e Malishevës” ishte bërë keq klasifikim i kodit të projektit gjatë ekzekutimit të pagesave. Fatura e pranuar me datën 11.11.2022 në vlerë 30,235€, ishte paguar të njëjtën ditë në dy pjesë nga dy kode të ndryshme të projektit. Pagesa 20,000€ ishte bërë nga kodi i projektit 51802 dhe pagesa 10,235€ ishte bërë nga kodi i projektit 51069;
- “Ndërtimi i garazheve, rregullimi i oborrit, renovimi i jashtëm i oborrit dhe pullazit të QKMF-së në Malishevë” ishte bërë keq klasifikim i kodit të projektit gjatë ekzekutimit të pagesave. Fatura e pranuar me datën 09.09.2022 në vlerë 51,305€, ishte paguar në tri pjesë nga tri kode të ndryshme të projektit. Pagesa 1,305€ ishte bërë nga kodi i projektit 51792; pagesa 30,000€ ishte bërë nga kodi i projektit 51793; dhe pagesa 20,000€ ishte bërë nga kodi i projektit 51272. Po ashtu për këtë projekt edhe fatura tjetër e pranuar me 07.11.2022 në vlerë 91,742€ e (situacionit të VI-të) ishte paguar nga katër kode të ndryshme të projekteve;
- “Asfaltimi i fshatrave Bubavec, Kijevë, Llazicë, Stapanicë, Plloqicë, Vermicë dhe Mleqan” ishte bërë keq klasifikim i kodit të projektit gjatë ekzekutimit të pagesave. Fatura e pranuar me datën 26.04.2022 në vlerë 75,874€, ishte paguar në tri pjesë nga tri kode të ndryshme të projektit. Pagesa 30,000€ ishte bërë nga kodi i projektit 51261; pagesa 39,764€ ishte bërë nga kodi i projektit 51267; dhe pagesa 6,110€ ishte bërë nga kodi i projektit 51784;
- “Ndërtimi i sheshit dhe rrugës Ibrahim Mazreku në qytetin e Malishevës” për faturën me nr. 22-SHV01-035-5 në vlerë 190,000€ të pranuar me datën 05.12.2022 komuna kishte paguar në 13 pjesë të gjitha me datën 08.12.2022 por nga 12 kode të ndryshme të projekteve. Po ashtu edhe fatura me nr. 22-SHV01-035-2 e datës 01.11.2022 në vlerë 319,810€ ishte paguar në katër pjesë nga kode të ndryshme të projekteve; dhe
- “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Bellanicë, Ngucat, Senik, Banjë, Temeqinë (situacioni VII-të)” ishte bërë keq klasifikim i kodit të projektit gjatë ekzekutimit të pagesave. Për faturën e pranuar me datën 02.09.2022 në vlerë 98,488.80€, ishte paguar në katër pjesë nga katër kode të ndryshme të projektit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të

brendshme, të hyrjeve në kontrata publike pa mjete të mjaftueshme për projekte të caktuara dhe shpenzimi i fondeve në projektet e caktuara me rastin e ekzekutimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Kjo ndikon në prezantime të gabuara të raporteve të progresit fizik dhe financiar të projekteve kapitale dhe rrezikon që buxhetimet e viteve vijuese të bëhen të pa sakta, po ashtu rritë mundësitë e vonesave në realizimin e projekteve dhe pagesat e faturave tjera.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave për investime kapitale për të gjitha rastet, të respektohen shumat dhe kodet e projektit përkatës siç janë të miratuara në ligjin e ndarjeve buxhetore, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshimin e shumave apo të projekteve atëherë të kërkohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave të pranuar

Gjetja Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, nenin 39.1, përcakton që "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se pesë (5) fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 171 ditë deri në 327 ditë.

- Fatura e pranuar me 23.07.2021 në vlerë 30,000€, ishte paguar me 15.07.2022.
- Fatura e pranuar me 23.07.2021 në vlerë 47,875€, ishte paguar me 15.07.2022.
- Fatura e pranuar me 24.12.2021 në vlerë 87,288€, një pjesë e saj në vlerë 15,000€, ishte paguar me 13.07.2022.
- Raporti i punëve të kryera për muajin Gusht 2022 për "Grumbullimin e mbeturinave, transporti dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike të komunës" në vlerë 17,175€ dhe i muajit shtator me vlerë të njëjtë, ishin ende të papaguara edhe në përfundim të punës audituese në terren (datë 13 prill 2023).

Shkaku i mospagesës së faturave të detyrimeve me kohë ishte mungesa e kontrolleve të brendshme funksionale dhe mungesa e mjeteve të buxhetuara për kodin ekonomik përkatës.

Ndikimi Detyrimet e bartura nga vitet paraprake rrisin rrezikun e realizimit të projekteve dhe arritjen e objektivave vjetore të komunës. Po ashtu, në rast të padive nga furnitorët mund të krijohen edhe kosto shtesë.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion, me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra, shërbime dhe komunalitet në vitin 2022 ishte 2,291,023€, prej tyre ishin shpenzuar 2,272,694€. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve kryesisht kanë të bëjnë me: shërbime kontraktuese tjera, furnizime mjekësore, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve ndërtesave dhe shkollave, mirëmbajtje e rrugëve, karburante për vetura, shpenzime me vendime të gjykatave, etj

Çështja B4 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013 - MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Dy pagesave për shpenzime të varrimit (6,440€ dhe 5,750€), ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime, këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve.

Keq klasifikimi i shpenzimeve nga një kategori në tjetrën ka ndodhur në mungesë të mjeteve financiare në kategorië e subvencioneve dhe transfereve.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria ekonomike jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve që prezantohen në PFV-të e komunës dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e tyre.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kode përkatëse ekonomike në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,914,644€, prej tyre në vitin 2022 ishin shpenzuar 4,902,314€ apo rreth 100%. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimi i rrugëve lokale, trotuareve, ujësjellësve, objekte arsimore, objekte kulturore, mirëmbajtje investive, pajisje mjekësore, etj.

Çështja A2 - Në specifikat teknike të tenderit mungon referimi i ndonjë standardi për pozicionet e punëve të kryera

Gjetja	Neni 28.4 i LPP kërkon: Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim. Gjatë vlerësimit të procedurave të prokurimit kemi vërejtur se me rastin e përgatitjes së specifikave teknike nga njësia kërkuuese, nuk ishin referuar në ndonjë standard të cilësisë për pozicionet e punëve që kërkohen të kryhen, kjo kishte ndodhur në dosjen e tenderit "Ndërtimi i fushave të futbollit të vogël në fshatin Kijevë-lagjja Stapanicë". Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme funksionale dhe mbikëqyrjes se duhur të njësia kërkuuese dhe në proceset e prokurimit.
Ndikimi	Kjo mund të ndikoi në cilësinë e punëve të kryera nga Operatori Ekonomik dhe po ashtu në jetëgjatësinë e përdorimit të atij investimi.
Rekomandimi A2	Kryetari duhet të siguroj se gjatë përgatitjes së specifikave teknike për punë, njësia kërkuuese duhet të përcaktoj edhe një standard të cilësisë së materialeve që kërkohen për realizimin e atij projekti.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A3 - Publikimi i kontratës me vonesë në sistemin e-prokurimi

Gjetja

Rregullore nr. 001/2022 për prokurim neni 45.36 përcakton, Pas nënshkrimit të kontratës, nga të dy palët, dhe publikimit të njoftimit për nënshkrim të kontratës (B52), kontrata do të jetë në disponueshmëri për t'u shkarkuar nga publiku, dhe zyrtarët brenda autoritetit kontraktues të ndërlidhur me implementim të kontratës.

Kontratat të cilat ishin nënshkruar dhe nuk janë publikuar në e-prokurim sipas rregullores, janë:

- "Ndërtimi i fushave të futbollit të vogël në fshatin Kijevë-lagjja Stapanicë", Kontrata ishte nënshkruar me datë 22.12.2022 ndërsa ishte vendosur në sistemin e-prokurimi me datën 11.01.2023, pra me 21 ditë vonesë.
- "Ndërtimi i rrugës Gurbardh - Turjakë komuna Malishevë", Kontrata ishte nënshkruar me datë 08.11.2022 ndërsa ishte vendosur në sistemin e-prokurimi me datën 11.01.2023, pra me 65 ditë vonesë.
- "Furnizim me materiale laboratorike për nevojat e QKMF-së", Kontrata ishte nënshkruar me datë 24.11.2022 ndërsa ishte vendosur në sistemin e-prokurimi me datën 11.01.2023, pra me 47 ditë vonesë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme funksionale dhe mbikëqyrjes se duhur të njësisë së prokurimit.

Ndikimi

Mos publikimi i kontratës në e-prokurim e zvogëlon transparencën ndaj procedurave dhe kontratave që i realizon Komuna.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratave, të bëhet publikimi i tyre në e-prokurim, në mënyrë që t'i mundësohet qasje të gjitha palëve të interesit sipas rregullores përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2022 kishte prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,460,689€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 2,285,226€, nga taksa komunale 990,739€ dhe nga qiraja e papaguar për shfrytëzimin e pronës publike 184,723€.

Çështja B5 - Dobësitë në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenin 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10€) dhe neni 27 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e Llogarive të Arkëtueshme (LIA). Siç shihet edhe më lartë, vlera e LI.A për tatimin në pronë, taksat në biznes dhe qiraja e papaguar, mbetin ende me vlera të larta dhe me trend rritës nga viti në vit.

Komuna nuk kishte ndërmarr veprime konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve, megjithëse, kjo situatë është ngritur si çështje dhe vitin e kaluar.

Mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë ishte kryesisht për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale të qytetarëve të komunës, ndërsa për taksat në biznese është për shkak se aty tanimë ka shumë biznese joaktive.

Ndikimi

Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve për vite me radhë, ndikon që ato të bëhen të pa mbledhshme dhe gjithashtu rezulton me të hyra vetjake më të ulëta për komunën.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e LI.A nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore. Ndërsa për LI.A nga taksa në biznes dhe të qirave, të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore dhe deri përmes mjeteve juridike me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,900,756	16,757,921	16,705,105	15,649,843	15,757,281
Grante Qeveritare - Buxheti	14,093,448	14,989,999	14,942,625	14,837,535	14,750,075
Financimi përmes huamarrjes	0	92,883	92,883	22,824	76,650
Të bartura nga viti i kaluar	0	640,429	640,071	0	263,417
Të hyrat vetanake	807,308	1,033,469	1,029,526	789,484	667,139
Donacionet vendore	0	508	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	632	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 1,857,164€. Kjo rritje ishte si rezultat i ndryshimit të bërë nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti paraprak dhe nga efekti i vendimit të qeverisë për shtesat në pagë për punonjësit shëndetësor të sektorit publik.

Në vitin 2022 Malisheva ka shpenzuar rreth 99.68% të buxhetit final ose 16,705,105€, me një rritje rreth 1% në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,900,756	16,757,921	16,705,105	15,649,843	15,757,281
Pagat dhe mëditjet	8,363,199	9,052,254	9,033,233	9,281,513	8,493,329
Mallrat dhe shërbimet	1,529,526	1,836,023	1,820,119	1,491,514	2,182,376
Komunalitë	455,000	455,000	452,575	447,985	454,914
Subvencionet dhe transferet	400,000	500,000	496,864	458,829	270,252
Investimet Kapitale	3,883,031	4,914,644	4,902,314	3,970,002	4,356,410
Rezervat	270,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Kategoria e pagave dhe mëditjeve në buxhetin final kishte një rritje për 689,054€ apo 8% krahasuar me buxhetin fillestar dhe një realizim prej 99.79%. Kjo rritje ishte për shkak të shtesave në paga për stafin shëndetësor dhe të kompensimeve të punëtorëve të arsimit përmes vendimeve gjyqësore për përmbushjen e kontratave kolektive sektoriale.
- Kategoria mallra dhe shërbime nga buxheti fillestar deri në fund të vitit kishte një rritje të buxhetit për 306,497€ dhe deri në fund të vitit ishte realizuar rreth 99%.
- Kategoria e Komunalive nga buxheti fillestar deri në fund të vitit nuk kishte ndonjë ndryshim të buxhetit, ndërsa kishte realizuar 452,575€ apo rreth 99%.
- Kategoria subvencioneve dhe transfereve kishte një rritje për 100,000€, deri në fund të vitit kishte realizuar rreth 99%.
- Kategoria investime kapitale nga buxheti fillestar deri në fund të vitit, kishte rritje të buxhetit për 1,031,612€ të cilat fillimisht ishin buxhetuar si rezerva dhe pastaj ishin rregulluar duke i buxhetuar për projekte kapitale dhe rritje nga të hyrat vetanake të bartura. Në fund të vitit kishte realizuar 99.75% të buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Malisheva në vitin 2022 ishin në vlerë 916,122€ apo rreth 113% nga planifikimi. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksa për lejet e ndërtimit, taksat për certifikata të ndryshme, të hyrat nga regjistrimi automjeteve, të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës, taks për regjistrim të trashëgimisë, të hyrat nga participimet (shëndetësi, arsim), të hyrat tjera administrative, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	807,308	807,308	916,122	911,454	597,329
Të hyrat tatimore	452,965	452,965	370,414	374,471	271,768
Të hyrat jo tatimore	354,343	354,343	540,917	533,004	325,561
Të hyrat tjera	0	0	4,791	3,980	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të Malishevës ka rezultuar në 11 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, dhe për pesë (5) tjera nuk ka filluar zbatimi, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare duke siguruar që të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurive duke krijuar regjistra të pasurisë të plotë dhe vlerat e tyre të jenë të sakta.	Këtë vit të gjitha pasuritë janë regjistruar.	I zbatuar
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë hartimit të PFV-ve, në mënyrë që PFV-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të nënshkruhet vetëm pasi që janë siguruar se PFV-të prezantojnë të dhëna të plota dhe të sakta.	Nuk ka çështje të njëjtë këtë vit.	I zbatuar

3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i komunës duhet të sigurojë një planifikim të duhur të kategorive ekonomike për të shmangur koston shtesë për keto pagesa.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se çdo shpenzim i bërë nga buxheti i komunës të bëhet për aktivitete të Komunës dhe interes publik si dhe të jetë në përputhje me ligjin mbi ndarjet buxhetore të vitit përkatës.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kode përkatëse ekonomike në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari.	Edhe ketë vit janë identifikuar keq klasifikime.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave për investime kapitale për të gjitha rastet, të respektohen shumat dhe kodet e projektit përkatës siç janë të miratuara në ligjin e ndarjeve buxhetore, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshimin e shumave apo të projekteve atëherë të kërkohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.	Gjendja edhe ketë vit është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare duke siguruar që të gjitha pasuritë e regjistruara kontrollohen nëse janë regjistruar në kategorin përkatëse, janë duke u kalkuluar normat adekuate të zhvlerësimit dhe regjistri i pasurisë të jetë i plotë dhe i saktë.	Çështja e zhvlerësimit të pasurive ka mbetur e pa korrigjuar edhe me tutje.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e LI.A nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore. Ndërsa për LI.A nga taksa në biznes dhe të qirave, të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore dhe deri përmes mjeteve juridike me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.	Gjendja është e njëjtë si në vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcoj kontrollet e brendshme duke e rrit mbikëqyrjen dhe verifikimin e rregullt të raporteve të obligimeve të papaguara, njëherit duhet të sigurojë që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.	Edhe ketë vit ka vonesa për pagesa të faturave.	Nuk ka filluar zbatimi

11.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcoi kontrollet e brendshme duke e rrit mbikëqyrjen dhe verifikimin e rregullt të raporteve të obligimeve të papaguara, për t'i nxjerr raportimet e plota dhe të sakta.	Ketë vit në raportet e obligimeve mujore nuk janë identifikuar çështje.	I zbatuar
-----	-----------------------	---	---	-----------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Enver Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leterkonfirmim

		
PRANUAR ME: 2705/2023 ACCEPTED ON: PRILJENO: Nr. No. Br: 04/578		
Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Financave dhe transfereve Kuvendi Komunal Malishevë		
LETËR E KONFIRMIMIT		
Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve		
Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit		
Të nderuar,		
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:		
• Kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Malishevës, për vitin 2022 • Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; • Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.		
 Z. Ekrem Kastrati		
Data: 25.5.2023, Malishevë,		

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.